



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01101/01-29520, datës 30.07.2019), duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të plotë të vendimit paraprak me numër 01 nr. 011/01-29516 të datës 30.07.2019 të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale- kiosqet, me datën 13.03.2020 rishpallë këtë:

NJOFTIM PUBLIK
Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale - Kiosqet

Ftohen të gjithë të interesuarit personat fizik dhe juridik që të aplikojnë për marrjen në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale-kiosqet

Pronat e paluajtshme që do të jepen në shfrytëzim afatshkurtër përmes njoftimit publik në afat prej 5 viteve janë kiosqet si në vijim:

	Z. Kadastrale	Pjesë e Parcelës	Adresa	Sipërfaqja
1	Gjakovë Z.K Qytet	1782-0	Nënë Tereza	6 m ²
2	Gjakovë Z.K Qytet	3351-1	Sadik Stavileci	12 m ²
3	Gjakovë Z.K Qytet	3431-1	Skenderbeu	6 m ²
4	Gjakovë Z.K Qytet	468-1	Sadik Stavileci	6 m ²
5	Gjakovë Z.K Qytet	577-0	Nënë Tereza	6 m ²
6	Gjakovë Z.K Qytet	3404-1	Vëllëzërit Frashëri	6 m ²
7	Gjakovë Z.K Qytet	3318	Bezistan	6 m ²
8	Gjakovë Z.K Qytet	3351-1	Sadik Stavileci	6 m ²
9	Gjakovë Z.K Qytet	3408-0	Nënë Tereza	6 m ²
10	Gjakovë Z.K Qytet	1041-0	Ismail Qemajli	6 m ²
11	Gjakovë Z.K Qytet	3375-1	Marin Barleti	6 m ²
12	Gjakovë Z.K Qytet	398-1	Nënë Tereza	6 m ²
13	Gjakovë Z.K Qytet	3307-1	Nënë Tereza	6 m ²
14	Gjakovë Z.K Qytet	3307-1	Mbreteresha Teuta	6 m ²
15	Gjakovë Z.K Qytet	709-1	Ismail Qemajli	6 m ²
16	Gjakovë Z.K Qytet	3375	Marin Barleti	12 m ²

Qëllimi:

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër i kiosqeve është:

- Përfitimi ekonomik i komunës përmes qiradhënies së kiosqeve;
- Funksionalizimi i kiosqeve.

Kushtet e veçanta:

- a) Në lokacionet e cekura objektet në fjalë (kiosqet) do të shërbejnë për këto destinime; Punte shërbyese për gazeta, revista, prodhime të duhanit, galanteri, suvenire, akullore, ushqime të shpejta dhe afarizëm të ngjashëm;
- b) Nuk lejohet të bëhet ndonjë destinim tjetër përveç atij që është përcaktuar më lartë;
- c) Shfrytëzimi i hapësirave të jashtme duhet të miratohet paraprakisht nga DUM-i, në bazë të rregullores për shfrytëzimin e hapësirave publike;
- d) Orari i punës të jetë sipas rregullores komunale në fuqi;
- e) Ndalohet çdo devijim nga plani fillestar i kiosqeve;
- f) Ndalohet shfrytëzimi i kiosqeve nga palët e treta;
- g) Aplikuesit mund të konkurrojnë vetëm për një kiosk;
- h) Pagesa e të gjitha komunalive që ndërliken me kiosqet, i bartë përfituesi-shfrytëzuesi;
- i) Përzgjedhja e fituesit bëhet në bazë të çmimit më të lartë të ofruar si dhe kritereve të përcaktuar në këtë njoftim publik;
- j) Vlera e çmimit fillestar është vendosur nga komisioni ndërsa aplikuesit përcaktohen për çmimin në ofertë;
- k) Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë të lidhur nëmës të komunës dhe fituesit (shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të komunës)

1) Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Dëshmitë mbi kryerjen e obligimeve tatimore së paku deri në tremujorin e fundit para; dorëzimit të ofertës;
- Vërtetimin e tatimit në pronë;
- Vërtetimin e tatimit ne biznes.

- 2) **Vendi dhe koha ku do të mbahet ankandi publik:** në objektin e Komunës, Rruga “UÇK” (ish objekti i Bankosit), kati IV, salla e Kuvendit të Komunës së Gjakovës.
- 3) **Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:** pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në ueb – faqen e Komunës. Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë “Komisionit për ankesa” në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb – faqen e Komunës.

Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, pas rekomandimit nga komisioni.

- 4) **Periudha e vlefshmërisë së ankandit publik do të jetë 15 ditë kalendarike, përkatësisht nga 13.03.2020 – 27.03.2020.**
- 5) **Ofertat** me dokumentacionin e plotësuar, duhet të dorëzohen në Komunën e Gjakovës, në Zyrën e Pranimi në katin përdhësë , 1 origjinal dhe 2 kopje, adresa: rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë.



Kryesuesi i Komisionit

Arben Bakalli
Arben Bakalli